



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS

Nr. 7287/T prot.

Tiranë, më 18/10 .2024

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. Nr.1712/1, datë 02.06.2014.

SHOQËRISË “KUKËS CHROME MINERALS” SH.P.K

Rr. Kukës-Tiranë km 3, Lagja Myc Mamëz, Zona kadastrale nr.2759, Nr pasurie 6/5, Kukës

Për dijëni: **AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE**
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë

Shoqëria “KUKËS CHROME MINERALS” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1712/1, datë 02.06.2014, për mineralin krom, në Objektivin “Laku i Çupit, Malzi”, Bashkia Kukës, Qarku Kukës.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 4281, datë 19.09.2024, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 7287 Prot., datë 20.09.2024, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1712/1, datë 02.06.2014, për mineralin krom, në Objektivin “Laku i Çupit, Malzi”, Bashkia Kukës, Qarku Kukës, pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar, lidhur me pagesën e garancisë financiare të rehabilitimit të mjedisit për vitet 2023 dhe 2024.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “ç” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në

Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr.1712/1, datë 02.06.2014, për mineralin krom, në Objektivin “Laku i Çupit, Malzi”. Bashkia Kukës, Qarku Kukës, që shoqëria Juaj zotëron.

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1712/1, datë 02.06.2014, për mineralin krom, në Objektivin “Laku i Çupit, Malzi”. Bashkia Kukës, Qarku Kukës, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

DHE

MINISTRI

DELINDA BALLUKU

ME URDHËR PËR DELEGIM

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

CENO KLOSI

